



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

05.06.2015 , Prishtinë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin Nr.03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2015, Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca XII), si dhe bazuar në Rregullorën e MAPL-së Nr.03.2013 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike Subvencione dhe Transfere shpall këtë:

**Thirrje për Projekt-Propozime**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me qëllim të avancimit të qeverisjes lokale, fton të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë me seli në komunat Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, që të aplikojnë për realizimin e projektit “Ta avancojmë vetëqeverisjen lokale së bashku”. Duke ditur se komunat e Republikës së Kosovës kanë një bazë të qëndrueshme ligjore, roli i organizatave të shoqërisë civile do të mund të përqendrohej në avancimin e mëtutjeshëm të modaliteteve qeverisëse, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. MAPL-ja vlerëson se përmes ndarjes së granteve do t’ju mundësojë strukturave komunale të jenë sa më afër ideve inovative të organizatave joqeveritare, të cilat janë në harmoni me legjislacionin gjegjës, dhe që njëherësh sugjerojnë dhe praktikojnë ide më pragmatike në të mirë të avancimit të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

### **Fushat prioritare që do të përkrahen janë si në vijim:**

- Inkurajimi i institucioneve qendrore dhe lokale që merren me vetëqeverisjen lokale si dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve që të rrisin kapacitetet, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e tyre;
- Përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe politikave biznesore, si dhe përkrahja në krijimin e një sistemi më efektiv të arsimit profesional teorik dhe praktik;
- Fuqizimi i veprimeve për sundim të ligjit, përmirësimi i qasjes së publikut në drejtësi dhe mekanizmat për të drejtat e njeriut, si dhe marrja e veprimeve për të luftuar korrupsionin në nivel lokal;
- Krijimi i metodave për të përmirësuar transparencën në funksionimin dhe efektivitetin e qeverisjes lokale;
- Identifikimi i ideve inovative për një promovim më të mirë të rolit pjesëmarrës të qytetarëve në nivel komunal dhe promovimi i forumeve aktive për të nxitur vullnetarizmin e qytetarëve;
- Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve etnike përmes përkrahjes së krijimit të lidhjeve politike, ekonomike dhe sociale, veçanërisht në veri të Kosovës;
- Propozimet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, apo shërbimet që ndikojnë në përmirësimin e kapaciteteve lokale, të cilat janë në pajtueshmëri me agjendën e BE-së.

### **Propozimet duhet të përmbajnë:**

- Propozimin ideor që përfshinë qëllimin dhe aktivitetet e projektit;
- Buxhetin e nevojshëm si dhe arsyetimin e secilës linjë buxhetore;
- Kornizën kohore për zbatim të aktiviteteve të projektit;
- Përshkrimin e përfituesve dhe pjesëmarrësve (të drejtpërdrejtë apo tërthortë, grupet e synuara);
- Përshkrimin e hollësishëm të kapaciteteve drejtuese të organizatës (personeli, pajisjet dhe shkathtësitë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj);
- Një kopje të regjistrimit të OJQ-së në pajtim me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës;

- Një vërtetim tatimor që vërteton se OJQ-ja është e regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), dhe se nuk ka ndonjë tatim apo detyrim të pashlyer.
- Kopjen e kartelës së Banke në emër të OJQ-së

### **Procesi dhe kohëzgjatja e projekteve:**

MAPL-ja do të përkrah projekt-propozimet për projekte me vlera të vogla që përmbushin kërkesat dhe fushat prioritare të lartpërmendura, të cilat garantojnë arritjen e rezultateve të synuara. Vetëm organizatat e sukseshme do të kontaktohen.

MAPL-ja inkurajon të gjitha OJQ-të që të aplikojnë me projekt-propozime të kësaj fushe. Projektet duhet të përfshijnë periudhën maksimale të zbatimit në kohëzgjatje prej 3 muajve si dhe të përfundojnë brenda vitit fiskal 2015. Aplikacionet e sukseshme do të publikohen në faqen tonë të internetit, jo më vonë se 7 ditë nga data e përzgjedhjes. MAPL-ja mban të drejtën e mosfinancimit në rast të dështimit të organizatës për t'iu përmbajtur projektit dhe afateve të caktuara.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Departamentin për Performancë dhe Transparencë Komunale në MAPL, përmes tel: 038 200 35 509, ose në uebfaqen e MAPL-së: <http://www.mapl-ks.org>, ndërkaq propozimet duhet të jenë të kompletuara e të mbyllura në zarf, ku duhet të shënohen informatat në vende të dukshëm të zarfit me këto të dhëna:

1. Projekt propozimi – Titulli i projekt propozimit,
2. Te dhënat e OJQ-së (Emri i plotë i OJQ-së, data e dorëzimit në Arkivin e MAPL-së, Emri i përfaqësuesit të OJQ-së;

Projekt Propozimet e kompletuara dorëzohen në Arkivin/ Shkrimoren e MAPL, ish-Objekti “Rilindja”, kati Përdhësë.

Data e fundit për aplikim është 16 qershor 2015, ora 15:00

